



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 129, datë 28.07.2021

MBI

**MIRATIMIN E FORMATIT TË LICENCAVE TË SHOQËRISË KOMISIONERE DHE
BANKËS, PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË INVESTIMIT NË TITUJ**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 13 dhe pikës 4, të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, pikës 5, të nenit 24, të Rregullores nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, pikës 1, të nenit 6, dhe pikës 48, të nenit 3, të Ligjit 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e formatit të licencave të shoqërisë komisionere dhe bankës, për ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Date ---. ----2021

ANEKS

LICENCA Nr. ..

Shoqëria “.....” sh.a., në bazë dhe për zbatim të nenit 13 të Ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, dhe Vendimit Nr. ..., datë të Bordit të AMF-së, licencohet për të ofruar shërbime investimi, në Republikën e Shqipërisë, si më poshtë:

Shërbimet e investimit

Instrumentet financiare

- | | |
|---|----------------------|
| 1. Marrja dhe transmetimi i urdhrave për një ose më shumë instrumente financiare. | 1, 2, 3, 4, 5, |
| 2. Ekzekutimi i urdhrave për llogari të klientëve | 1, 2, 3, 4, 5, |
| 3. Tregtimi për llogari të vet | 1, 2, 3, 4, 5, |
| 4. | |

Shërbime ndihmëse:

1. Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve;
2. Dhënia e kredive ose e huave një investitori për t’i dhënë mundësi të kryejë një transaksion me një ose më shumë instrumente financiare, ku shoqëria që jep kredinë ose huanë, ose një subjekt tjetër i lidhur me të, është e përfshirë në transaksion;
3.

ERVIN METE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV



Shenim : Listimi i instrumenteve financiare eshte si me poshte:

1. titujt e transferueshëm;
2. instrumentet e tregut të parasë;
3. kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive;
4. kontratat e opsioneve (options), kontratat e së ardhmes (futures), marrëveshjet e shkëmbimit (swap), kontratat që paracaktojnë normën e interesit në të ardhmen dhe çdo kontratë tjetër derivative lidhur me tituj, monedha, norma interesi ose kthimi (yields), kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë ose instrumente të tjera derivative, indekse financiare ose njësi financiare, të cilat mund të shlyhen fizikisht ose me para;
5. kontratat e opsioneve (options), kontratat e së ardhmes (futures), marrëveshjet e shkëmbimit (swap), kontratat e shitjes në të ardhmen me çmim të paracaktuar (forwards) dhe çdo kontratë tjetër derivative në lidhje me mallra (commodities) që duhet të shlyhen në para ose që mund të shlyhen në para me zgjedhjen e njëërës prej palëve, duke përjashtuar rastet e zgjidhjes së kontratës për mospërbushje ose për ndonjë arsye tjetër;
6. kontratat e opsioneve (options), kontratat e së ardhmes (futures), marrëveshjet e shkëmbimit (swap) dhe kontrata të tjera derivative në lidhje me mallra (commodities), që mund të shlyhen fizikisht me kusht që të tregtohen në një treg të rregulluar, në një platformë shumëpalëshe tregtimi, ose në një platformë të organizuar tregtimi, me përjashtim të produkteve energjetike të tregtuara me shumicë në një platformë të organizuar tregtimi, të cilat duhet të shlyhen fizikisht;
7. kontratat e opsioneve (options), kontratat e së ardhmes (futures), marrëveshjet e shkëmbimit (swap) dhe kontrata të tjera derivative në lidhje me mallra (commodities), që mund të shlyhen fizikisht e që nuk janë përmendur në shkronjën “dh” më sipër, të cilat nuk mbahen për qëllime tregtare, por kanë karakteristikat e instrumenteve të tjera financiare derivative;
8. instrumentet derivative për transferimin e riskut të kredisë;
9. kontratat financiare për diferencë;
10. kontratat e opsioneve (options), kontratat e së ardhmes (futures), marrëveshjet e shkëmbimit (swap), kontratat që paracaktojnë normën e interesit në të ardhmen dhe çdo kontratë tjetër derivative në lidhje me variablat klimaterike, çmimet e transportit të mallrave ose normat e inflacionit, ose statistika të tjera ekonomike zyrtare, e cila duhet të shlyhet me para ose mund të shlyhet me para me zgjedhjen e njëërës prej palëve, duke përjashtuar rastin e zgjidhjes së kontratës për mospërbushje apo ngjarje tjetër, si edhe çdo kontratë tjetër derivative në lidhje me aktive, të drejta, detyrime, indekse dhe masa që nuk përmenden më sipër, e cila ka karakteristikat e instrumenteve të tjera financiare derivative, duke mbajtur parasysh, ndër të tjera, nëse tregtohen në një treg të rregulluar, platformë të organizuar tregtimi ose platformë shumëpalëshe tregtimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

LICENCË
PËR TË OFRUAR SHËRBIME INVESTIMI

Nr..., datë ...202..

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bazë dhe për zbatim të nenit 13 të Ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, dhe Vendimit Nr. ..., datë të Bordit të AMF-së, i jep subjektit,

“BANKA” SH.A.

Licencën për të ofruar shërbime investimi në Republikën e Shqipërisë.

Licenca i lejon “.....” sh.a., të kryejë shërbimet e investimit të përshkruara në Aneksin bashkëlidhur.
Licenca është e pakufizuar në kohë, e patransferueshme dhe e patjetërsueshme.

ERVIN METE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

LICENCË
PËR TË OFRUAR SHËRBIME INVESTIMI

Nr., datë

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bazë dhe për zbatim të nenit 13 të Ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, dhe Vendimit Nr. ..., datë të Bordit të AMF-së, i jep subjektit,

“ A B C.” SH.A.

Licencën e shoqërisë komisionere për të ofruar shërbime investimi në Republikën e Shqipërisë.

Licenca i lejon “.....” sh.a., të kryejë shërbimet e investimit të përshkruara në Aneksin bashkëlidhur.
Licenca është e pakufizuar në kohë, e patransferueshme dhe e patjetërsueshme.

ERVIN METE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

